




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South



DREJTORIA PËR PLANIFIKIM DHE URBANIZËM



RAPORTI

Gjashtëmuji i Punës së Drejtorisë
Për periudhën kohore 17 Janar – 17 Korrik 2026

Drejtori: Ardian Kavaja

Mitrovicë e Jugut
Korrik 2026

HYRJE

1. DREJTORIA PËR PLANIFIKIM DHE URBANIZËM

Në bazë të Organogramit kjo Drejtori e kryen funksionin Administrativ përmes këtyre 4(katër) Sektorëve siç janë:

1. **Spektori për Urbanizëm,**
2. **Spektori për Planifikim,**
3. **Spektori për Legalizim dhe**
4. **Spektori për Banim,** dhe në kuadër të Drejtorisë ekziston **Zyrtari Ligjorë**

Bazuar në përshkrimin e punëve dhe detyrave të punës së stafit të Drejtorisë, secili është angazhuar në kryerjen e punëve të parapara në fushën përkatëse të përgjegjësisë dhe për punët e kryera gjatë gjashtëmujorit të parë të punës, paraqesin raportin me shkrim.

Gjatë përpilimit të Raportit gjashtëmujor për punët e kryera në DPU, për periudhën kohore 17 Janar -17 Korrik për gjashtëmujorin e parë të vitit **2026**, rezulton se janë kryer këto punë:

1.1. Spektori për Urbanizëm

Ka bërë në vazhdimësi shqyrtimin e kërkesave të palëve në lëmin e përgjegjësisë të cilat i ushtron siq janë: Lëshimi i Kushteve të ndërtimit, Lëshimi i Lejeve të ndërtimit, për objekte shumë banesore, individuale afariste ekonomike dhe të tjera.

Kontrollimin e projekteve të dorëzuara për kategorinë e **I-rë** dhe të **II-të**, të ndërtimit
Llogaritjen e sipërfaqeve të lejuara për ndërtim, llogaritjen e taksës sipas Tarifës ndërtimore të Miratuar nga Ministria përkatëse.

Lëshimin e pëlqimeve për Objekte ekonomike – bujqësore,

Përgaditja e Raportit të lejeve të ndërtimit për zyrën e Auditimit Kombëtar.

Shqyrtimi i kërkesave të palëve për ndërrim të destinimit të kulturës së tokës nga tokë bujqësore në tokë ndërtimore.

-Hartimi i Protokolit për kategorinë e I-parë, objekte banimi	13
-Të Refuzuara	2
-Hartimi i protokolit për kategorinë e II-të, objekte shumëbanesore	5
-Të refuzuara.....	0
-Për vazhdimin e Kushteve Ndërtimore.....	1
-Përgjigje në kërkesë	7
-Pëlqime.....	3
-Konfirmime.....	1
	2

- Kërkesa për Qendrën Rajonale të Trashëgimisë së Kulturës (QRTK), për shqyrtim të dokumentacionit për parcelat afër objekteve nën mbrojtje, me qëllim të vazhdimin të procedurave për leje të ndërtimit	1
Vendime për ndërrimin e kulturës nga tokë bujqësore në tokë ndërtimore	26
Vendime për leje rrërimi	7
Të refuzuara për leje rrërimi	3

Leje të lëshuara për Ndërtim:

- Leje Ndërtimore – Kategoria I	12
- Leje Ndërtimore – Kategoria II	3
- Refuzime për Leje Ndërtimore Kategoria I	11
- Refuzime për Çertifikata për përdorim të objekteve	1
- Pëlqime.....	4
- Pezullime.....	24
- Refuzime për Pëlqime/Konfirmime.....	1
- Në proces.....	10

1.2 Sektori për Planifikim

- Shqyrtimi i 1(nje) kërkesë për parcelizim;
- Shqyrtimi i 35(tridhjet e pesë) kërkesave për destinim të parcelave sipas PZHK 2020-2028;
- Shqyrtimi i 1(një) kërkesë për marrjen e Pëlqimit për veprimtari Auto-Parking;
- Shqyrtimi i 2(dy) kërkesave për DGJKP.

1. Shqyrtimi i 36 lëndëve për shfrytëzimin e përkohëshme të sipërfaqeve publike (kiosqet) dhe pëlqime për panele solare

Të Aprovuara 25

Të Refuzuara 9

Të Pezulluara 1

Hapësirat Publike

1. Të Shqyrtuara i 101 lëndë për vendosjen e objekteve të përkohëshme në sipërfaqe dhe hapësira publike, anekse, tavolina dhe karrige, çadra etj.
2. Të aprovuara 53 lëndë për shfrytëzim të sipërfaqeve dhe hapësira publike.
3. Të refuzuara 30 lëndë për shfrytëzimin e sipërfaqeve dhe hapësirave publike.

- Shqyrtimi i kërkesave të pranuar gjatë vitit për Pano Reklamuese dhe Reklama.....	125
- Të Miratuara	44
- Të Refuzuara	-

1.3 Zyrtari Ligjorë- procedurat Juridike Administrative

- Propozim-Vendim Kryetarit, për Formimin e Komisionit për percjellje të punëve për vendosjen e Ashensorit në objektin e Komunës.
- Propozim-vendim Kuvendit për Formimin e Komisionit për rivlersimin e gjendjes ekonomike-sociale të familjeve përfituese sipas programit për Banim Social.
- Propozim-Vendim drejtuar Kryetarit të Komunes, për formimin e komisionit për plotësim-ndryshim të Rregullorës Komunale Nr.01-2023 për shfrytëzimin e përkohshëm të sipërfaqeve dhe hapësirave publike.
- Propozim-Vendim drejtuar Kryetarit të Komunes, për formimin e komisionit për hartimin e Rregullorës për Bonuse të Zonimit.
- Hartimi i 13 (trembëdhjetë) Kontratave për dhënien me qera të lokaleve afariste për më pak se 1(një) vit, në pronësi apo menaxhim të Komunës.
- Kryesues i Komisionit për shqyrtimin e ankesave kundër vendimeve të Inspektoriatit
Janë shqyrtuar 10 (dhjetë) ankesa kundër vendimeve të Inspektoratit, ku të gjitha kanë rezultuar të refuzuara si të paligjshme.
- Kryesues i Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për marrjen në shfrytëzim për më pak se 1 vit të pronës së paluajtshme të Komunës.
- Kryesues i Komisionit për shqyrtimin e ankesave të palëve kundër vendimeve të DPU-së për shfrytëzimin e hapësirave publike.

1.4 Sektori për Banim

Në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi në Sektorin për Banim, gjatë kësaj periudhe janë realizuar detyrat në përputhje me legjislacionin në fuqi, aktet nënligjore, planin e punës së drejtorisë dhe kërkesat e qytetarëve, me fokus në administrimin e çështjeve të banimit, menaxhimin e pronës komunale, zbatimin e projekteve të banimit social dhe ofrimin e shërbimeve profesionale për qytetarët.

Gjatë periudhës raportuese janë realizuar këto punë :

- Është realizuar procedura administrative për **shpalljen e listës së përfituesve** në kuadër të Projektit të Banimit Social Adekuat (BSA), nënprojekti **“Renovimi/Rindërtimi i shtëpive për familjet e rasteve të cënueshme sociale”**, duke përfshirë verifikimin e dokumentacionit, hartimin dhe publikimin e listës së përfituesve, si dhe përgatitjen e përgjigjeve ndaj kërkesave dhe ankesave të aplikuesve.
- Është përgatitur dhe proceduar në Kuvendin Komunal **propozim-vendimi për formimin e Komisionit për Vlerësimin dhe Verifikimin e Familjeve që banojnë në banesa dhe shtëpi në pronësi të Komunës së Mitrovicës**, me qëllim evidentimin e gjendjes faktike dhe verifikimin e përmbushjes së kriterëve për vazhdimin e shfrytëzimit të tyre.
- Janë lëshuar **7 vërtetime për shtëpitë të djegura gjatë luftës**, sipas kërkesave të qytetarëve dhe dokumentacionit zyrtar në dispozicion.
- Janë shqyrtuar dhe trajtuar 15 kërkesa të qytetarëve në fushën e banimit, janë përgatitur përgjigje zyrtare, vendime, kontrata, informata, vërtetime dhe shkresa të tjera administrative në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Janë përgatitur përgjigje zyrtare për aplikuesit e Projektit të Banimit Social Adekuat (BSA), gjithsej 46 lëndë të cilët nuk kanë përfituar nga nënprojekti për shkak të mosplotësimit të kriterëve të përcaktuara në thirrjen publike.
- Është zhvilluar koordinim i vazhdueshëm me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Njësinë për Menaxhimin e Projektit, drejtoritë komunale dhe institucionet tjera relevante për zbatimin e aktiviteteve në fushën e banimit.
- Janë ndërmarrë aktivitetet për hartimin e Programit Komunal të Banimit 2026–2030, në përputhje me Ligjin për Banim Social dhe të Përballueshëm, duke kontribuar në mbledhjen e të dhënave, analizimin e nevojave dhe përgatitjen e dokumentacionit përkatës.
- Angazhim aktiv dhe kontribut në **Komisionin për Hartimin e Plotësim-Ndryshimit të Rregullores për Taksa, Tarifa dhe Prona Komunale**, me fokus në shqyrtimin dhe propozimin e ndryshimeve që tangjentojnë kompetencat e Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm, duke kontribuar në harmonizimin e dispozitave me legjislacionin në fuqi.
- Është bërë **shqyrtimi profesional dhe kontrolli i tre (3) listave kontrolluese për aplikime për leje ndërtimore të kategorisë II**, në aspektin e zbatimit të dispozitave të **Normave Minimale Teknike për Ndërtesat e Banimit në Bashkëpronësi**, duke verifikuar përputhshmërinë e dokumentacionit projektues, respektimin e standardeve teknike dhe duke dhënë rekomandime profesionale.
- Angazhim në Komisionin komunal për riintegrim
- Angazhim në Komisionin komunal për Hartimin e Planit Komunal për Riintegrimin e personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunën e Mitrovicës së Jugut

- Janë proceduar 13 kontrata të reja si dhe janë shpërndarë në vazhdimësi faturat për pagesa të qerave për shfrytëzimin e lokaleve në pronësi apo menaxhim të Komunës së Mitrovicës së Jugut.

1.5 Sektori për Legalizim

Lëndë të aplikuara për Legalizim	42
Vendime për Legalizim	53
Vendime për listë të pritjes	23
Të Regjistruara në Librat Kadastral.....	127
Vendim refuzimi	0
Kerkesa në proces	5

Kemi një numër të rritur të aplikuesve të cilët e kanë rregulluar Pronësinë e parcelave prandaj kemi një ndryshim të Vendimeve nga

Vendimi i listës së pritjes në vendim të legalizimit, gjithashtu edhe numri i regjistrimeve në RDPP (Kadastër) është rritur.

1.6. Evidenca e të hyrave gjatë periudhës 13 Janar - 16 Korrik 2026 në DPU:

Taksa për Leje të Ndërtimit	173,443.65 €
Taksa për ndërrim të Destinimit të Tokës ...	31,874.00 €
Legalizimi i objekteve	34,084.69 €
Taksa për fletëkërkesa	0.00 €
Taksa për reklama	4,938.28 €
Shfrytëzimi i pronës publike	65,670.81 €
Qiraja e lokaleve tregtare	11,919.62 €
Qiraja nga prona Publike (banesa).....	0.00 €
Shitja e pasurisë- banesat e vjetra	0.00 €
Totali i të hyrave për këtë periudhë:	321,931.05 €

1.7 Evidenca e Lëndeve të pranuar në DPU për periudhes 13 Janar - 13 Korrik 2026

Lëndë të pranuar	639
Lëndë në proces	579
Lëndë të miratuara	39
Lëndë të Refuzuara	6
Të hedhura poshtë	0
Të Pezulluara	0
Të Anuluara	14
Ceduar	1



Drejtori i DPU-së

Ardian Kavaja